

UNMIK/REG/2008/1
8 janar 2008

RREGULLORE NR. 2008/1

**MBI NJË NDRYSHIM NË KORNIZËN KUSHTETUESE PËR
VETËQEVERISJE TË PËRKOHSHME NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, dhe Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/29 mbi ndryshimin e Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në pajtim me nenin 14.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të ndryshimit të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshim

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut nr. 2001/9) ndryshohet si vijon:

1. Në nenin 9.2.3, fjala “katër” ndryshohet në “pesë”,

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 8 janar 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm